UDHËZIM
Nr. 26, datë 17.12.2021

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 35, DATË 21.9.2020, "PËR KONTROLLIN, REGJISTRIMIN, PËRDORIMIN, RAKORDIMIN, RAPORTIMIN DHE PUBLIKIMIN E FONDEVE TË FINANCIMEVE TË HUAJA NË KUADRIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE"

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", në rastet kur, në fazën e aplikimit për përfitimin e fondeve nga projektet e financimit të huaj grant, donatorët kërkojnë një numër llogarie bankare të institucionit përfitues të grantit, ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

UDHËZON:

1. Pas paragrafit 4.3, të udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", shtohet paragrafi i mëposhtëm:

Në rastet kur, në fazën e aplikimit për përfitimin e fondeve nga projektet e financimit të huaj grant, donatorët kërkojnë një numër llogarie bankare të institucionit kandidat për fitimin e projektit, atëherë të përdoret llogaria e unifikuar e Thesarit "Depozitë e Qeverisë" (TSA) në EUR në Bankën e Shqipërisë:

Emërtimi i llogarisë: "Depozita e Qeverisë në euro"
IBAN: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E
Banka e Përfituesit: Banka e Shqipërisë
Kodi SWIFT/BIC: STANALTRXXX
Adresa e Bankës: Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Albania
Account Holder: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, Albania
Adresa: "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, Albania,

në vend të llogarisë bankare speciale (tranzite), të hapur në Bankën e Shqipërisë në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuar me emërtimin e projektit të financimit të huaj, vetëm për transferimin e mjeteve monetare të kështit të parë të disbursimit të grantit.

Përshkrimi në dokumentin e transfertës së mjeteve monetare nga donatori në TSA të përmbajë emërtimin e saktë të projektit dhe të përfituesit të grantit, pasi mbi bazën e këtij informacioni do të kryhet transferta në llogarinë operative të përfituesit të grantit në bankën e nivelit të dytë (jashtë TSA-së) për shpenzim dhe kontabilizim në sistemin informatik financiar të qeverisë.

2. Hapja e llogarisë operative të përfituesit të grantit në bankën e nivelit të dytë, kur të përdoret fondi, kryhet detyrimisht mbi bazën e marrëveshjes së nënshkruar nga palët në zbatim të udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare".

3 Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë e zbatimit të projekteve me financim të huaj, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj